



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranimi - Përmirësimi më Datë: 25-11-2025			
Nr. i Organi Org. Broj	Numri i Broj	Shtypja Përdor	Vlera Vrednost
01-	060/01-	1748	



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të Nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e X të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë: **27.11.2025 (e Enjte), në ora 10:00.**

Mbledhja do të mbahet në zyrën e konferencave të objektit të vjetër të Komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për projekt buxhetin e Komunës së Vitisë 2026-2028

Viti, më 25.11.2025

Me respekt!
Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E NËNTË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **24.09.2025 (e mërkurë)**, në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i kuvendit komunal), z.Illir Zuka, z.Ramadan Deliu, z.Jakup Demiri, znj.Majlinda Shabani, zn.Zejnepe Osmani, ndërsa mungoi: zn.Zyrafete Rama. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se ka anëtarë për kourum, kryesuesi i kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Përshëndetje për nënkryetarin e komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje dhe ju të tjerë pranishëm. Mirë se keni ardhur në mbledhjen e nëntë të rregullt të KPF-së! Pra, materialin e keni marrë me kohë, e dimi që në kete seanc bazur në Ligj ka qen dashur të jete edhe projek bugjeti për vitin 2026-2029 mir po draft na ka ardhë si propozim mir po nuk ka ardhë i kompletuar me pjese e investimeve kapitale me ka njoftu edhe nënkryetari është një koordinim me asosacionin e komunave që ky bugjet të vjen masi të zgjidhet kuvendi i ri kryetari i ri i orienton projektet. Para se me hi në rend dite, hapi diskutim, nëse ka jasht rendit të ditës.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje për të gjithë punën e buxhetit! Nuk e di që a ka të drejtë apo nuk ka Asociacioni i Komunave, por unë e di se në muajin shtator duhet të kryhet miratimi i buxhetit. Dhe tjetra, është raporti i auditorit kombëtar, duhet me ardh deri në fund të shtatorit mu diskutu, sepse i humbim dy pikë tek vlerësimi i performances me e sjell e me diskutu në kuvend që me e kalu.

z.Illir Zuka: Unë po flas për dy raste që i patëm në komunën tonë, që kanë raste të rënda. Po i shprehi ngushëllime familjes dhe të gjithë atyre që i njoft, sidomos ky rasti në Viti ke jashtëzakonisht i ran aksidenti, dhe ky rasti në Debelldë. Po uroj që mos të përsëriten këto raste ma, dhe lus që mos të politizohen këto raste. Unë nuk e di çka ka faj komandanti i stacionit policor, kur ata i kanë kry punët e veta. Ne duhet mos me leju me politizu. Unë e di që ka pas edhe nga kandidatët për kryetar që ka kërku dorëheqjen e komandantit, gjë që u kanë banale kërkesa e tij, sepse policia e ka kry punën e vet jashtëzakonisht mirë.

Kryesuesi z.Bekim Azizi: Institucionet duhet me e kry punën me përgjegjësi. Unë nuk kam pas qëndrim politik, edhe mendoj që nuk duhet me pas. Shpresoj që këto raste tragjike mos të na përsëriten më.

znj.Majlinda Shabani: Përshëndetje për të gjithë! E kam një kërkesë prej Irfanit të OSBE-së, për një deklaratë me e dërgu në kuvend, për miratim. Ata kërkojnë që me e sjellë në kuvend për miratim, edhe pse nuk e kanë sjell draft buxhetin, po mu doket e qëllimshme kjo. Edhe çështja e konkurseve në arsim, duha ta di si është gjendja.

Kryesuesi z.Bekim Azizi: Nuk e di a e kanë kalu kuvendet tjera. Po e shofim këtë sa i përket buxhetit. Unë thash edhe më parë, nuk kam shkresë nga Asociacioni i komunave, po e di që e ka ba një kërkesë që, Ministria me ja leju komunave që me e miratu buxhetin komunal pas zgjedhjeve. E siç ka qenë përgjigja e ministrisë nuk e di.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! U ngritën tri çështje, edhe unë

jam që mos të politizohen çështjet e fatkeqësive. E dyta, çështja e Asociacionit të Komunave është një mekanizëm rekomandues, jo vendimmarrës, dhe ka rekomandu ndoshta në aspektin profesional, se aty marrin pjesë krejt kryetarët e komunave, po vendim nuk kemi nga ana e ministrisë. Po, pasi që nuk e kemi të konstituim kuvendin e nivelit qendror, se krejt buxhetet e komunave dhe të ministrisë miratohen në kuvend. Ata e kanë mendu këtë formë, dhe kryetari i jonë është anëtar i bordit, dhe ju ka bashkëngjitur atyre, dhe çështja e tretë që u shtriu, çështja e konkurseve, që me të vërtetë është e dhimbshme në këtë kohë, se po kalojnë 20 ditë dhe ka mungesë të personelit, të cilët nuk janë plotësuar. Ndoshta e keni pa në rrjetet sociale të shkruar, po unë po mundohem me thanë realitetin se si qëndron. Ka pas një konflikt për kompetenca, të cilët nuk janë pajtues Zyra e DKA-së me Zyrën e Personelit. Më kanë pyetur edhe mu si jurist, unë kam dhënë mendimin tim të cilin është dashtë me ba veprimin tjetër, që tash sërish, kur e kemi ba këtë veprim ai sërish u terjek nga to kompetencat e veta Njësia e Personelit, dhe nuk e ka bërë verifikimin e dokumenteve të cilat kenë edhe në takim, që duhet me ju dhanë zgjidhje konfliktit. Ka ndodh në rastin konkret, jo individual, po rastin konkret. Po kanë qenë tri katër pozita në të cilat nuk ka pas nga universiteti i shtetit, dhe është sugjeru që, në rast se nuk ka nga universiteti i shtetit, atëherë nëse i kanë diplomat e licencume i merr në mungesë të asaj, i jep përparësi tij edhe e kryen konkursin. Ai ka këmbëngul që nuk i thirri, dhe këtu ka ndodh ajo çështja e zhagitjes. Tash pjesërisht nuk ke mujt me kry. Konkursi ka qenë dashur me e anuluar si tërësi, me i nda kompetencat, me i tregu se tuat janë vetëm me i verifiku, po jo me i ndalu, se nuk mundesh me i ndalu, as nuk mundesh me e përsërit konkursin 10 here. Konkursi thotë nuk ki, nuk i plotëson kushtet. P.sh.: me fakultet i plotëson, ky tjetri e merr për një vit shkollor. E këto janë problemet, e besoj se do të kalohet edhe kjo. Me ligj, deri me 30 shtator është me e miratu buxhetin. Duhet me kalu, po tash duhet me pa lidhjen me asociacionin. Do të shikoj planin e veprimit të auditorit a është gati e ta procedojmë tutje.

z.Jakup Demiri: E murrem një informatë rreth buxhetit, edhe pse nuk po me doket e arsyeshme. E sa ju përket konkurseve në arsim, e dimë krejt ne pse janë anuluar. Nuk është në pyetje ajo që po thua ti. Unë kam familjar të mi që kanë konkuru, po pa shku me u taku me Sokol Halitin në zyrë, ta thamë me përgjegjësi më të lartë, se përndryshe nuk bëhet kjo punë. Që tri vite ren Komuna e Vitisë është tu e humb grandin e performancës. Raporti i auditorit është tu dal keq. Edhe para katër vite në fushatë nuk janë pas publiku emrat e të pranuarve, ama 30 shtatori është obligim ligjor. Raporti i auditorit me ardh në kuvend me kalu, sepse i humb dy pikë. Në Smirë, në disa lagje ka fillu me vendos ndriçim publik, se shkon para derës së oborrit ja kanë vendos, edhe e kanë pyetur sa anëtar të familjes i ki.

z.Ilir Zuka: Të gjithë ata kandidat që janë mësimdhënës deri në zgjedhje, nuk kanë të drejtë me qenë pjesë e arsimit. A e din që ish pshtjell në shkolla se kush është tu dhanë mësim. P.sh.: Zyrafeti nuk guxon me shku me dhanë mësim, sepse është kandidat. Unë po e ngris si shqetësim këtë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka për debat rreth rendit të ditës, materialin e keni marrë, vazhdojmë me rend të ditës.

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në bujqësi në Komunën e Vitisë për vitin 2025.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Planin e Punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2026.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin e punës të Komitetit për Komunitet për vitin 2026.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Komunitet: Gjilani, Kamenicë, Viti, Novobërdë, Parteshi, Klllokot, Ranillug, Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Han i Elezit, Shtërpçë, dhe Vendimi për Pëlqim Mjedisor Nr. 5496-2/25, i datës 20.08.2025, Ministria e Mjedisit, Planifikimit dhe Infrastrukturës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e KPF-së

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A ka dikush vërejtje rreth procesverbalit? Atëhere, e qes në votim: a jeni që të miratohet procesverbali me këto ndryshime? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet dhe procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në bujqësi në Komunën e Vitisë për vitin 2025

z.Avni Misini nga Drejtoria e Bujqësisë: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pasi që drejtori nuk është prezent, po ja prezantoj raportin për vlerësimin e dëmeve, e ku i kemi disa ndryshime për kuvend. Raporti është përgatit nga komisioni, të cilin e keni pranuar me kohë. Për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Në listën që e kemi prezen i kemi 173 fermer. E ti thave që ka me pas ndryshime kjo listë. Sa do të jetë lista, sa mrrin numri?

z.Avni Misini nga Drejtoria e Bujqësisë: Numri i fermerëve mrrin në 180. Kjo listë përmirësohet për në kuvend.

z.Illir Zuka: Me sa e di unë, nga 2021 ka pas dëme në këtë formë edhe ato nuk jan kompenzu. Sipas disa informatave që i kam unë, Ministria e Bujqësisë që nga viti 2023 u bë një bartje prej Ministrisë së Bujqësisë në Ministri të Punëve të Brendshme. Nuk e di çka i lidh këto dy ministry: a naj shpjegon këtë.

z.Avni Misini nga Drejtoria e Bujqësisë: Jo nga vitit 2021, por prej 2023 nuk janë kompenzu. Përpara kanë qenë në Ministri të Bujqësisë, prej 2023, me vendim të Qeverisë, buxheti ka dal në Ministri të Punëve të Brendshme, Agjensioni për Emergjencë. Tash aty jemi të obliguar me i dorëzu dokumentacionet. Prej momentit që janë dal në këtë agjension nuk ka pas pagesa.

z.Illir Zuka: A i keni dorëzu ju dokumentacionet, këto raporte? A keni marr naj konfirmim që a do të kompenzohen apo jo?

z.Avni Misini nga Drejtoria e Bujqësisë: Po këtë raport që e miraton kuvendi ne e dorëzojmë në agjensi, dhe ne e marrim të protokollume nga agjensia. Me thanë të drejten në 2023 unë vet kam qenë atje, më kanë thanë që është e kryme, vetëm çështje dite për mu bë pagesa, po se çka ka ndodh nuk e di.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit! A jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend e ndryshuar? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, edhe kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Planin e Punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2026

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Plani ka qenë në diskutim publik, i punuar nga komisioni. A ka diçka për me diskutu? Nëse jo, e qes në votim. Me votat e të gjithëve u miratu edhe kjo pikë që të shkon në Kuvend.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Planin e Punës së Komitetit për Komunitet për vitin 2026

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ky komitet e ka pru planin. Nëse keni me diskutu diskutojmë, nëse jo e dërgojmë në kuvend. Me votat e të gjithëve edhe kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e peste e rendit të ditës:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Komunitet: Gjilan, Kamenicë, Viti, Novobërd, Partesh, Klllokot, Ranillug, Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Han i Elezit, Shtërpçë dhe Vendimi për Pëlqim Mjedisor Nr. 5496-2/25, i datës 20.08.2025, Ministria e Mjedisit, Planifikimit dhe Infrastrukturës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të shkoj kjo pikë në kuvend? Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim.


Faleminderit për kontributin!

Shihemi në mbledhjet tjera!

Mbledhja përfundoi në ora 10:45

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi



Republika e Kosovës

Komuna e Vitisë

Bazuar në nenin 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr 28/2008), dhe nenit 50 shkronja I) të Statutit të Komunës së Vitisë me numër 013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë :

**PROPOZIM VENDIM
PËR PROJEKT BUXHETIN E KOMUNËS SË VITISË 2026-2028**

Neni 1

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal që të aprovoj Vendimin „PROJEKT BUXHETI I KOMUNËS SË VITISË 2026-2028“

Duke u bazuar në QARKOREN BUXHETORE 2026/02 të datës 21.08.2025 të lëshuar nga MFPT-ja me nr 2992/2025 ku paraqet bazën për hartimin e buxhetit për vitin 2026-2028.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi është „PROJEKT BUXHETIN E KOMUNËS SË VITISË 2026-2028“ e hartuar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim . Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2026 është në shumë prej 18,324,215 €. Buxheti për vitin 2027 është në shumë prej 18,822,498 €. Buxheti për vitin 2028 është në shumë prej 19,732,692 €.

Neni 3

Burimet e buxhetit janë: të hyrat nga grandit qeveritar dhe nga të hyrat vetanake komunale.

Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e komunës së Vitisë për vitin 2026 janë:

- | | |
|--|--------------|
| a) Të hyrat nga Grandi Qeveritar | 18,324,215 € |
| b) Të hyrat vetanake komunale | 17,029,555 € |
| | 1,294,660 € |

Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e komunës së Vitisë për vitin 2027 janë:

- | | |
|--|--------------|
| c) Të hyrat nga Grandi Qeveritar | 18,822,498 € |
| d) Të hyrat vetanake komunale | 17,431,697 € |
| | 1,390,801 € |

Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e komunës së Vitisë për vitin 2028 janë:

- | | |
|--|--------------|
| e) Të hyrat nga Grandi Qeveritar | 19,732,692 € |
| f) Të hyrat vetanake komunale | 18,335,730 € |
| | 1,396,962 € |

Buxheti për vitin 2026 shpërmdahet në këto kategori ekonomike :

Paga e mëditje	10,870,225. €
Mallra e shërbime	3,078,919. €
Shpenzime komunale	290,000. €
Subvencione dhe transfere	720,000 €
Shpenzime kapitale	3,365,071 €
<u>Totali i buxhetit</u>	<u>18,324,215 €</u>

Neni 4

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset Kryetari dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë dhe e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

PROPOZUES : KRYETARI I KOMUNËS

Sokol Haliti





REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA			
Prilidhet: 01-09-2025			
Nr. Llogarit	Titulli	Shifra	Vlera
02-	309/AR		1329

KOMUNA E VITISË

PLAN BUXHETI 2026-2028

Drejtoresha e drejtoris për FEZH

Milihate Ajeti

Kryetari i Komunës

Sokol Haliti

Shtator 2025

PLAN BUXHETI 2026-2028

Buxheti është instrumenti më i rëndësishëm i politikës ekonomike që ka në dispozicion qeveria komunale, dhe si i tillë ai pasqyron prioritetet e saja zhvillimore. Derisa buxheti rregullon të hyrat dhe shpenzimet për një vit fiskal të caktuar, procesi buxhetor është i vazhdueshëm dhe përsëritet çdo vit. Komuna në muajin qershor ka hartuar Kornizën Afatmesme Buxhetore të shpenzimeve (KAB-i), një dokument planifikues afatmesëm që synon të përmirësojë parashikueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e buxhetit, duke përfshirë buxhetin e vitit të ardhshëm fiskal dhe parashikimet buxhetore edhe për dy vitet fiskale të tjera, kur hartohet buxheti vjetor, Ministria e Financave e Punës dhe Transfereve ka nxjerr qarkoret buxhetore 1 dhe 2 që japin kufijt fillestar dhe final, informata dhe udhëzime rreth strukture së shpenzimeve në fonde burimore dhe kategori ekonomike për vitin e ardhshëm fiskal dhe parashikimet për dy vitet pasuese, përcaktojnë procesin e bashkërendimit midis organizatave buxhetore dhe Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve. Në bazë të këtyre propozim-buxheteve, Ministria e përgatitë Propozim - Buxhetin e Kosovës dhe Projekt ligjin për ndarjet buxhetore dhe ia dorëzon për shqyrtim qeverisë. Qeveria duhet ta paraqesë projektligjin për shqyrtim në Kuvend deri më 31 tetor të vitit aktual fiskal.

Përgatitja e buxhetit 2026 - 2028 ka filluar nga muaji maj i vitit 2025, konform LMFPF dhe Ligjit të Financave të Pushtetit Lokal. Këtë periudhë kohore e kanë përcjell dy qarkore buxhetore të lëshuara nga MFPT-ja, qarkorja e parë buxhetore 2026/01 të datës 15.05.2025 dhe qarkoren e dytë të datës 15.08.2025.

Me qarkoren buxhetore 2026/01 jemi njoftuar për kufijt fillestar të shpenzimeve të granteve buxhetore për vitin 2026 si dhe parashikimet për vitin 2027 dhe 2028si dhe me qarkoren e dytë 2026/02 janë përcaktuar kufijt final të kategorive ekonomike.

Plan buxheti i vitit 2026 është përgatitur në bazë të Statutit të Komunës së Vitisë, duke bërë shpërndarjen e fondeve nëpër drejtori / programe dhe nënprograme.

Në qarkoren e dytë buxhetore 2026/02 janë dhënë kufijt e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike (duke përfshirë shpenzimet e pagave dhe shtesave, mallëra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere dhe investime kapitale) për vitet 2026-2028.

Buxheti komunal për vitin fiskal 2025-2028 do të paraqitet sipas 5 kategorive ekonomike për shpenzimet e buxhetuara në pajtim me rregullat e thesarit:

1. Paga e shtesa,
2. Mallëra dhe shërbime,
3. Shpenzime komunale,
4. Subvencione e transfere, si dhe
5. Shpenzime kapitale

KUFIJT BUXHETOR SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE PËR VITET 2025-2028					
nr.	Kategorit ekonomike	2025	2026	2027	2028
1	Paga e mëditje	9,887,124	10,870,225	10,924,576	10,979,199
2	Mallra e shërbime	3,172,919	3,078,919	3,028,919	3,028,919
3	Shpenzime komunale	300,000	290,000	315,000	315,000
4	Subven. e transfere	720,000	720,000	720,000	720,000
5	Shpenzime kapitale	3,865,579	3,365,071	3,834,003	4,689,574
	Totali	17,945,622	18,324,215	18,822,498	19,732,692

Dallimi i buxhetit në mes të viteve 2025 dhe 2026


nr.	Kategorit ekonomike	2025	2026	Diferenca/ ndryshimi
1	Paga e mëditje	9,887,124	10,870,225	983,101
2	Mallra e shërbime	3,172,919	3,078,919	(94,000)
3	Shpenzime komunale	300,000	290,000	(10,000)
4	Subven. e transfere	720,000	720,000	-
5	Shpenzime kapitale	3,865,579	3,365,071	(500,508)
	Totali	17,945,622	18,324,215	378,593

Buxheti i Komunës së Vitisë përbëhet nga dy burime kryesore.

1. **Grantet qeveritare** (granti i përgjithshëm, granti specifik i arsimit dhe granti specifik i shëndetësis dhe granti për shërbime rezidenciale),
2. **Të hyrat vetanake komunale.**

Buxheti i Komunës në vitet 2024 – 2028

Buxheti sipas viteve	
Viti 2025	17,945,622.00
Viti 2026	18,324,215.00
Viti 2027	18,822,498.00
Viti 2028	19,732,692.00



Buxheti i Komunës së Vitisë si tërësi ka shënuar rritje në vitin 2026 në krahasim me vitin 2025 në vlerë prej 378,593 € ose prej 2.11 %.

Rritje është reflektuar në grantin specifik të arsimit në vlerë prej 312,312 €, rritje në grantin specifik të shëndetësis 41,748 €, total grantet qeveritare kanë rritje prej 354,060 €.

Të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje në shumë prej 24,533 €.

Duke u bazuar në qarkoren buxhetore 2026/02 buxheti i shpërndarë nëpër kategori ekonomike për vitin 2026:

1. Kategoria ekonomike e pagave dhe shtesave

Kemi rritje të kategoris ekonomike të pagave dhe shtesave në vlerë prej 983,101 €.

Kategorinë ekonomike të pagave e mëditjeve e ndarë në katër linja buxhetore :

Programet	Shuma në €	%
Administrata	1,887,018.00	17.36
Arsim e shkencë	7,278,281.00	66.96
Shëndetsi dhe mirëqenje sociale	1,573,871.00	14.48
Shërbimet sociale-rezidenciale	131,055.00	1.21
Totali	10,870,225.00	100.00

2. Kategoria ekonomike mallëra dhe shërbime

Duke u bazuar në qarkoren buxhetore 2026/02 është bërë zbritja e kategorisë ekonomike të mallërave e shërbimeve nga viti 2026 në shumë prej 94,000.00 € e shpërndarë në këto linja buxhetore:

Programet	Shuma në €	në %
Administrata	1,691,684.00	54.94
Arsim e shkencë	490,000.00	15.91
Shëndetsi dhe mirëqenje sociale	847,235.00	27.52
Shërbimet sociale dhe rezidenciale	50,000.00	1.62
Totali	3,078,919.00	100.00

- Grantet qeveritare kan marrë pjesë në mallëra e shërbime në shumë prej 2.749,828 €
- Të hyrat vetanake kan marrë pjesë në mallëra e shërbime në shumë prej 379,091 €.

3. Kategoria ekonomike shpenzime komunale

Shuma e mjeteve në kategorinë ekonomike të shpenzimeve komunale është zvogluar në vlerë prej 10.000 € në krahasim me vitin 2025 , dhe tërësisht është e financuar nga granti qeveritar me një total prej 290,000 € në këto linja buxhetore.

Programet	Shuma në €	në %
Administrata	157,200	54.21
Arsim e shkencë	75,000	25.86
Shërbimet sociale dhe rezidenciale	5,000	1.72
Shëndetsi dhe mirëqenje sociale	52,800	18.21

4. Kategoria ekonomike subvencione dhe transfere

Kategoria e subvencioneve dhe transfere në vitin 2026 janë në vlerë të njëjt si në vitin 2025 prej 720,000 € e shpërndarë në këto programe:

Programet	shuma në €	në %
Zyra e kryetarit	170,000	23.61
Kulturë, Rini e Sport	150,000	20.83
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	350,000	48.61
Shërbimet sociale	50,000	6.95
Totali	720,000	100.00

5. Kategoria ekonomike e investimeve kapitale

Te kategoria e investimeve kapitale në vitin 2026 ishin në vlerë prej 3,365,071 €, kemi zbritje të buxhetit në vitin 2026 në vlerë prej 500,508 € .

Në vitin 2026 investimet kapitale janë në shumë prej 3,365,071 € .

Investimet kapitale nga grantet e qeveris	2,619,502.00 €
Investimet kapitale nga të hyrat vetanake	745,569.00 €

Shuma e investimeve kapitale e shpërndarë në këto programe:

Programet	Shuma në €	Në %
Administrata	3,105,071	92.27
Arsim e shkencë	150,000	4.46
Shëndetsi dhe mirëqenje sociale	60,000	1.78
Shërbimet sociale-rezidenciale	50,000	1.49
Totali	3,365,071	100.00

Shpërndarja e buxhetit për vitin 2026 është si vijon :

1 . Administrata	7,510,973 €
2. Arsimi	7,993,281 €
3. Shëndetësia dhe mirëqenja sociale	2,533,906 €
4. Shërbimet sociale	286,055 €

Totali	18,324,215 €
---------------	---------------------

SHPËRNDARJA E BUXHETIT SIPAS LINJAVE DHE GRANTEVE PËR VITIN 2026

Shpenzimet e linjave buxhetore	Paga & shtesa	Mallra e shërbime	Komunal	Subvencione dhe transfere	Investime kapitale	Totali	Nr. max i
160 Administrata komunale	1,887,018	1,691,684	157,200	670,000	3,105,071	7,510,973	198
920 Arsim	7,278,281	490,000	75,000	-	150,000	7,993,281	819
730 Shëndetësi dhe mirëqenja sociale	1,573,871	847,235	52,800	-	60,000	2,533,906	149
755 Shërbimet sociale- rezidenciale	131,055	50,000	5,000	50,000	50,000	286,055	15
TOTALI	10,870,225	3,078,919	290,000	720,000	3,365,071	18,324,215	1181

Shpenzimet e granteve buxhetore	Paga & shtesa	Mallra e shërbime	Komunal	Subvencione dhe transfere	Investime kapitale	Totali
10 Granti i përgjithshëm	2,677,115	1,873,582	237,200	500,000	2,572,168	7,860,065
10 Granti i Arsimit	6,717,513	435,111	-	-	47,334	7,199,958
10 Granti i Shëndetësis	1,475,597	441,135	52,800	-	-	1,969,532
21 Të hyrat vetanake	-	329,091	-	220,000	745,569	1,294,660
TOTALI	10,870,225	3,078,919	290,000	720,000	3,365,071	18,324,215

SHPËRNDARJA E BUXHETIT SIPAS LINJAVE DHE GRANTEVE BUXHETORE

Tabela e plan buxhetit për vitin 2026

Kodi	Viti	Nr i puntorëve	Totali i granteve	Granti i përgjithshëm	Granti i arsimit	Granti i shëndetësisë	Të hyrat vetanake
657	Programet	1181	18,324,215	7,880,085	7,199,958	1,969,532	1,294,660
	Administrata	198	7,510,973	6,436,313	-	-	1,074,660
111	Paga dhe shtesa		1,887,018	1,887,018			179,091
130	Mallra e Shërbime		1,691,684	1,512,593			
132	Shpenzime Komunale		157,200	157,200			
200	Subvencione dhe transfere		670,000	470,000			200,000
300	Shpenzime kapitale		3,105,071	2,409,502			695,569
	Arsimi	819	7,993,281	723,323	7,199,958	-	70,000
111	Paga dhe shtesa		7,278,281	560,768	6,717,513		
130	Mallra e Shërbime		490,000	4,889	435,111		50,000
132	Shpenzime Komunale		75,000	75,000			
200	Subvencione dhe transfere		-	-	-		
300	Shpenzime kapitale		150,000	82,666	47,334		20,000
	Shëndetësia	149	2,533,906	434,374	-	1,969,532	130,000
111	Paga dhe shtesa		1,573,871	98,274		1,475,597	
130	Mallra e Shërbime		847,235	306,100		441,135	100,000
132	Shpenzime Komunale		52,800			52,800	
200	Subvencione dhe transfere		-	-	-		
300	Shpenzime kapitale		60,000	30,000			30,000
	Shërbimet sociale	15	286,055	266,055	-	-	20,000
111	Paga dhe shtesa		131,055	131,055			
130	Mallra e Shërbime		50,000	50,000			
132	Shpenzime Komunale		5,000	5,000			
200	Subvencione dhe transfere		50,000	30,000			20,000
300	Shpenzime kapitale		50,000	50,000			

Tabela përmbledhëse

Kategorit ekonomike	Granti i përgjithshëm dhe grantet specifike	E hyra vetanake	Shuma në €
Paga dhe shtesa	10,870,225	0	10,870,225
Mallra e shërbime	2,749,828	329,091	3,078,919
Shpenzime komunale	290,000	0	290,000
Subvencione dhe transfere	500,000	220,000	720,000
Shpenzime kapitale	2,619,502	745,569	3,365,071
TOTALI	17,029,555	1,294,660	18,324,215

Forma finale e plan buxhetit për vitin 2026

		Shpenzimet					Burimet e financimit				
		Mallra dhe shërbime	Shpenzimet Komunale	Subvencione dhe transferet	Shpenzime kapitale	Totali	Granti i përgjithshëm	Granti specifik i arsim	Granti specifik i shëndetësisë	HVK	Totali
Drejtoria	Nr. pun	Paga e shitesa									
Totali i Administratës	198	1,887,018.00	1,691,684.00	670,000.00	3,105,071.00	7,510,973.00	6,433,313.00	0.00	0.00	1,077,660.00	7,510,973.00
Zyra e kryetarit	37	418,000	150,000	170,000.00		738,000.00	648,000.00			90,000.00	738,000.00
Zyra e kuqendit komunal	27	262,830	12,000			274,830.00	272,830.00			2,000.00	274,830.00
Administrata dhe personeli	33	252,212	88,000			340,212.00	336,212.00			4,000.00	340,212.00
Buxheti e Financa	25	228,818	60,000		3,105,071.00	3,393,889.00	2,688,320.00			705,569.00	3,393,889.00
Inspektioni	8	87,886	70,000			157,886.00	157,886.00			0.00	157,886.00
Shërbimi publik komunal dhe em	34	329,153	1,185,684	167,200.00		1,672,037.00	1,565,946.00			106,091.00	1,672,037.00
Buxheti Pajant dhe Zh. Rural	6	55,633	10,000	350,000.00		415,633.00	315,633.00			100,000.00	415,633.00
Kadaster - Gjeodazi, Prindori	8	71,039	10,000			81,039.00	81,039.00			0.00	81,039.00
Urbanizim, Planifikim, Mjedis	5	54,005	55,000			109,005.00	109,005.00			0.00	109,005.00
Kulturë Rriti e Sport	12	99,648	50,000	150,000.00		299,648.00	223,648.00			76,000.00	299,648.00
Zak	3	27,794	1,000			28,794.00	28,794.00			0.00	28,794.00
Totali i Arsim	817	7,278,281.00	490,000.00	75,000.00	150,000.00	7,993,281.00	723,323.00	7,199,958.00	0.00	70,000.00	7,993,281.00
Drejtoria e Arsim	9	98,386.00	24,889.00	75,000.00		198,275.00	178,275.00			20,000.00	198,275.00
SH.M. Kuvendi i Lezhës "	67	580,233.00	51,772.00		150,000.00	782,005.00	545,048.00	216,957.00			781,605.00
SH.M. Jonuz Dajçullahu"	78	689,718.00	41,080.00			730,798.00	730,798.00				730,798.00
Sh.M. Kongrat i Manastirit; Poshtran	25	213,143.00	21,942.00			235,085.00	235,085.00				235,085.00
Befli Hashu -VIII	50	445,782.00	21,006.00			467,788.00	467,788.00				467,788.00
Hali Alidema -Poshtran	45	402,638.00	30,100.00			432,738.00	432,738.00				432,738.00
Almet Hajdari- Beguncë	28	251,761.00	17,937.00			269,698.00	263,718.00				263,718.00
Shander Emarihu-Ramjan	22	194,661.00	12,252.00			206,913.00	206,913.00				206,913.00
Nazmi Pajaziti-Radivoje	37	335,668.00	17,206.00			352,874.00	352,872.00				352,872.00
